

SHOQERIA AYEN AS ENERGJI sha
NIPTI L11731504A

Datë, 26/03/2012

DEKLARATE

Deklaroj se Shoqëria AYEN AS ENERGJI sha me NIPT L11731504A me administrator Z/ Fahrettin Amir Arman dhe aksionere:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. SHOQERIA AYEN ENERJII ANONIM SIRKETI | perqindja e pjesemarrjes 82 % |
| 2. SHOQERIA AS ENFRGY | perqindja e pjesemarrjes 9 % |
| 3. Ayel Elektrik Uretim Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi | perqindja e pjesemarrjes 8 % |
| 4. Z. Fahrettin Amir Arman | perqindja e pjesemarrjes 1 % |

ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2011 konform standarteve kombetare te kontabilitetit.

Hartuesi i pasqyrave financiare eshte:

Z/ EDUARD RECI (kontabël i miratuar) me NIPT L01306506P /

Administratori i Shoqërisë

Fahrettin Amir Arman

P/ Ahmet BISHAK-GJATEPE



RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare te Shoqerise
"AYEN AS ENERGJI" sha

Xhafzotaj

Rruga Nationale Tirane – Durres prane Albafleks

Lidhur me shqyrtimin e llogarve vjetore te periudhes qe mbyllet me Dhjetor 2011.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te shoqerise AYEN AS ENERGJI Sha (me poshte "Shoqeria") qe permbajne bilancin kontabel me date 31 Dhjetor 2011 si dhe pasqyren perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve per ketë ushtrim, pasqyren e rruksit te parase dhe pasqyren e ndryshimeve te kapitaleve te veta, dhe te tjera shënime sqaruese.

Pergjegjësité e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: percaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare te cilat nuk permbajne keq-deklarime materiale, qofte si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve te duhura kontabel; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabel te arsyeshme per rrethanat financiare.

Pergjegjësité e Audituesit te Pavarur

Pergjegjësia jone është te shprehim nje opinion per pasqyrat financiare duke u bazuar ne auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tone ne pajtim me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarde kerkojne qe ne te permbushim kerkesat e etikes dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin me qellim qe te perfitojme nje siguri te mjaftueshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne keq-deklarime materiale. Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per sigurimin e te dheneve te auditimit per shumate dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura jone ne gjykimin e audituesit, duke perfshire vleresimin e rrezikut te keq-deklarimeve materiale, qofte si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjate vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare te shoqerise ne menyre qe te percaktojë procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat financiare, por jo per cëllimin e shprehjes se nje opinion per efektivitetin e kontrollit te brendshem te shoqerise. Nje auditim gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se parimeve te kontabilitetit te perdorura dhe pranueshmerine e çmuarjeve kontabile te kryera nga drejtimi, si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se te dhënat e auditimit qe ne kemi siguruar jane te mjaftueshme dhe te pershtatshme per te bazuar opinionin tone.

Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te Shoqerise japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te gjendjes financiare te Shoqerise me 31 Dhjetor 2011 si dhe te rezultateve te aktivitetit te saj per ushtrimin e mbyllur me ketë date ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Emri i Firmes Audituese

Gjini Consulting Shpk

Date:

27 Mars 2012



GJINI
CONSULTING
REGISTERED AUDITORS

Firma e Partnerit te Angazhimir.



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2011

	Shenime	Ne leke 31.12.2011
<u>Aktive Afatajate</u>		
Aktive Afatgjata Materiale		7,219,577
Aktive te tjera afatgjata (ne proces)		141,167,187
Totali i Aktiveve Afatgjata	4	148,386,764
<u>Aktive Afatshkurtra</u>		
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	5	22,609,873
Kapitali aksionar i paguar	6	12,600,000
Aktive te tjera Financiare afatshkurter		2,755,465
Uogari kerkesa te tjera te arketueshme	7	2,755,465
Mjetet Monetare	8	82,779,380
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		120,084,717
TOTAL I AKTIVEVE		269,081,481
<u>Kapitali</u>		
Kapitali i aksionar		140,000,000
Fitimi i pashperndare		-
Fitimi (humbje) e vitit financiar		(17,746,807)
Totali i Kapitalit	9	122,253,193
<u>Detyrime Afatajate</u>		
Huamarrje te tjera afatgjata	10	106,519,266
Detyrime Totale Afatgjata		106,519,266
<u>Detyrime Afatshkurtra</u>		
Huate dhe parapagimet		40,309,022
Te pagueshme ndaj furnitoreve	11	35,859,198
Detyrimet ratimore	12	449,824
Detyrime Totale Afatshkurtra		40,309,022
Totali i Detyrimeve		146,828,288
TOTAL I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		269,081,481

Pasqyrat Financiare duhet te lexohen se bashku me shenimet bashkangjitur.

AYEN AS ENERGI Sha

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERSHIRESE
Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2011

Pershkrimi	Shenime	Ne leke 2011
Shitje neto		-
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		-
Ndryshimet ne inventarin e Pgatshem dhe Pproces		-
Puna e kryer nga njesia ek per qellime te veta		-
Mallra, lendet e para dhe sherbimet		-
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	13	(5,153,244)
Shpenzimet e personelit	14	(4,383,753)
Fogat		(16,499,591)
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore		(492,051)
Shpenzimet per personelin		12,607,889
Amortizimi dhe zhvleresimet	4	(756,153)
Fitimi (humbje) nga veprimtarite e shfrytezimit		(10,293,150)
Te ardhura dhe shpenzime financiare		
Te ardhura/shpenzime finan. nga investime te tjera financiare		
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		1,979,057
Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit		(9,426,714)
Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare		
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	15	(7,453,657)
Fitimi (humbje) para tatimit		(17,746,807)
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	16	-
Fitim (humbje) neto e vitit financiar		(17,746,807)

Pasqyrat Financiare duhet te lexohen se bashku me shenimet bashkangjitur

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE
Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2011

PASQYRA E FLUKSIT ILE PARASE	Ne Jekë 2011
A Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	
Fitimi para tatimit	(17,746,807)
Rregullime për:	
Amortizimin	756,153
Humbje nga këmbimet valutore	9,426,714
Të ardhura nga investimet	
Shpenzime për interesa	(1,973,057)
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera	(37,965,337)
B Rritje/rënie në tepricën inventarit	
C Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, nën t'u paguar nga aktiviteti	40,309,022
D MM të përfituara nga aktivitetet	
E Interesi i paguar	
G Tatim mbi fitimin i paguar	
MM neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	(7,193,317)
H Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara	
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(149,142,918)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	
I Interesi i arkëtuar	1,973,057
J Dividendët e arkëtuar	
MM neto e përdorur në aktivitetet investuese	(147,169,861)
K Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare	
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner	140,000,000
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	106,519,266
Pagesat e detyrimeve të qirësë financiare	
Dividendët e paguar	
MM neto e përdorur në aktivitetet financiare	246,519,266
Diferenca nga këmbimet valutore	(9,426,714)
Rritja (+)/rënia(-) neto e injekteve monetare	82,729,380
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	82,729,380

Pasqyrat Financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet bashkëngjitur

AYEM AS ENERGJI Sha

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL
Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2011

	Kapitali aksionere	Aksione te thesarit	Rezerva ligjore statutore	Rezerva te konvertimit te	Fitimi pashperndare	Totali
B Pozicioni me 31/12/2010						
1 Fitim neto per periudhen kontabel					(17,815,006)	(17,815,006)
2 Dividentet te paguara						
3 Rritje e rezerves se kapitalit						
4 Emisimi i kapitalit aksionar	140,000,000					140,000,000
5 Aksione te thesarit te biera						
Fitimi i pashperndare						
C Pozicioni 31/12/2011	140,000,000				(17,815,006)	122,184,994

Pasqyrat Financiare te vitit 2011 u aprovuan ne ___ Mars 2011 nga administratori Fahrettin Amir Arman dhe jane firmosur ne emer te tij nga:

AHMET BURAK GOKTERE
Ahmet Burak Goktere



EDUARD RECI



AYEN AS ENERGJI Sha
Shenime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2011

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Te dhena te pergjithshme mbi Shoqerine

Shoqeria AYEN AS ENERGJI sha eshte themeluar me daten 31.05.2011. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit Nr.7638 date 19 Nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe nga statute i saj.

Kapitali i shoqerise eshte ndare ne 1,400 pjese me vlere nominale 100,000 leke per nje vlere totale prej 140,000,000 ALL. Kontributi i nrtkeve te shoqerise detajohet si meposhte:

<u>Ortaket</u>	<u>Perqindja e pjesmarries</u>
Fahrettin Amir Arman	1%
AS ENERGY	9%
AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI	82%
Ayel Elektrik Uretim Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi	8%

Perfaqesuesi ligjor i shoqerise eshte Z. Fahrettin Amir Arman

Sipas kontrates koncesionare me nr. 5446 rep, nr. 1944 kol, te dates 02.05.2011 miratuar me VKM Nr.365 date 04.05.2011, e cila ka hyre ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare Nr.62 date 23.05.2011; aktiviteti kryesor i shoqerise percaktohet te jete financimi, projektimi, venia ne pune, administrimi dhe mirembajtja e hidrocentraleve Golan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit dhe e Fargut. Ne perfundim te kontrates koncesionare do te kryhet transferimi i objekteve te siperpermeadura tek Autorizati Kontraktues

2. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel

a. Menyra e Prgatitjes se Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare te shoqerise jane pregatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Pasqyrat financiare te shoqerise jane pregatitur mbi bazen e kostos historike, me perjashtim te rasteve qe percaktohet ndryshe ne se ka te tille.

b. Ndryshime ne metodat e vleresimit kontabel

Rishikimi i vleresimit kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi (cmuarja) eshte dhe ne cdo periudhe qe preket ne te ardhmen.

c. Transaksionet ne monedhe te huaj

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (A.L), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e shoqerise. Informacioni financiar eshte paraqitur ne Leke.

Transaksioneve ne monedhe te huaj regjistrohen ne kontabilitet me kursin e dates se kryerjes se transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane perkthyer ne pasqyren e bilancit me kursin e kombimit te Bankes se Shqiperise me 31.12.2011. Diferencial nga kursi i kombimit te linduara nga perkthimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet ja monetare qe maten me kosta historike ne monedhe te huaj perkthohen duke perdorur kursine kombimit ne daten e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet ja monetare ne monedhe te huaj qe paraqiten me vleren e drejte perkthohen me kursin e kombimit ne daten kur vlera e drejte eshte percaktuar.

Kursi i kombimit per dy monedhat e huaja kryesore me monedhen vendase sipas te Bankes se Shqiperise me 31.12.2011, ka qene respektivisht si me poshte:

AYEN AS ENERGJI Sha
Shënime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2011

	2011
1 Euro	138.93
1 USD	107.54

d. Vleresimi Aktiveve Afatgjata Materiale

Aktivët Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten ne bilanc me vleren e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen ne kontabilitet me koston se marrjes ose te prodhimit te tyre.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me bërjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vërtëtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë, çdo kosto tjetër të lëshuar direkt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për përdorimin e synuar, si dhe koston e smontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendrëndësues së aktivit. Programet e blera që janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjeve me të cilat lidhen kapitalizohen si pjesë e atyre pajisjeve.

Normat e amortizimit të aplikuara janë sipas kërkesave fiskale dhe nuk marrin ne konsideratë vleresimin e amortizimit sipas jetes së dobishme të aktivit. Aktivët e ndërtuara zhvlerësohen nga dita ata janë të disponueshme për përdorim.

Për llogaritjen e amortizimit janë aplikuar keto norma amortizimi:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit %	Metoda e llogaritjes
	2011	
Toka	0	
Ndërtime e instalime	5	
Makineri e Pajisje	20	Mbi vleren e mbetur te AQT-ve
Mjete transporti	20	
Pajisje zyre	20	
Pajisje kompiuterike	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	

Llogaritja e amortizimit për AAM e hyra gjate vitit behet duke filluar nga data nje e muajit pasardhës.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar çmimin e shitjes me vlerën kontabël dhe përfshihen ne pasqyrën e konsoliduar te të ardhurave gjithëpërfshirëse

Kosto e interesat nga huamarrjet që përdoren për financimin e ndërtimit të aktiveve afatgjata material janë kapitalizuar gjate periudhës kohore që është e nevojshme për te kompletuar dhe përgatitur aktivin për përdorim. Shpenzimet e tjera të dorxhit janë shpenzuar.

Koston e mirëmbajtjes apo shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata material njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin. Përmirësimet e aktiveve ekzistuese kapitalizohen kur ato ndodhin.

e. Rënia ne vlerë e Aktiveve Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata materiale rishikohen për rënie në vlerë sa here që ka ngjarje ose ndryshime ne kushtet aktuale që tregojnë se vlera e kontabël e aktivit mund të mos jetë e rikuperueshme. Kur vlera kontabël e një aktivi është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme e tij, një humbje nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e konsoliduar te të ardhurave gjithëpërfshirëse. Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mos vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus koston e shitjes.

AYEN AS ENERGJI Sha
Shënime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2011

Vlera e tregut minus kostot e shitjes përcaktohet nga shitja e një aktivi në kushtet e tregut, ndërsa vlera në përdorim është vlera e skontuar e flukseve të ardhshme monetare që pritet të rezultojnë nga përdorimi i aktivit dhe nga nxjerrja e tij jashtë përdorimit në përfundim të jetës së dobishme. Shumat e rikuperueshme janë vlerësuar për asetet individuale ose, kur ka qene e mundur, për njësite gjeneruese të mjeteve monetare.

f. Aktivet financiare

Kompania i klasifikon investimet sipas kategorive të mëposhtme: aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, huatë dhe të arkëtueshmet, investimet e mbajtura deri në maturim, dhe aktivet financiare gati për shitje. Klasifikimi lidhet me qëllimin për të cilin janë blere investimet.

Drejtimi vendos mbi klasifikimin e investimeve në njohjen fillestare dhe rishikon këtë klasifikim në çdo raportim.

Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes janë aktive financiare të mbajtura për tregtim. Një aktiv financiar është i klasifikuar në kategorinë nëse është blerë me qëllim për t'u shitur në një periudhë afat – shkurtër. Aktivet në këtë kategori janë klasifikuar si aktive korrente. Kompania nuk ka asnjë aktiv të klasifikuar në këtë kategori në datën e raportimit.

Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare jo derivate me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv letrash me vlerë. Ato përfshihen në aktivet korrente përveç atyre që maturohen në një periudhë me të gjatë se 12 muaj mbas datës së raportimit. Huatë dhe të arkëtueshmet përfshijnë në datën e raportimit llogari të tjera të arkëtueshme, si edhe aktive monetare.

Aktivet financiare të disponueshme për shitje

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo derivate që janë të përcaktuara në këtë kategori ose nuk mund të klasifikohen në asnjë nga kategoritë e tjera. Ato përfshihen në aktivet jo-korrente përveç se kur Drejtimi ka vendosur të shosi këto investime brenda 12 muajve mbas datës së raportimit. Kompania nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

Kontabilizimi

Të gjithë aktivet financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë duke shtuar kostot e transaksionit.

Aktivet financiare e regjistrohen, kur të drejtat për të përfituar flukse të mjeteve monetare prej tyre kanë skaduar ose kur ata janë transferuar dhe kur Shoqëria ka transferuar në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin.

Aktivet financiare të disponueshme për shitje dhe aktivet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes maten edhe me pas me vlerën e drejtë. Huatë, të arkëtueshmet, dhe investimet e mbajtura deri në maturim maten me kostot e amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të "aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes" janë të përfshira në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave gjithëpërfshirëse si fitime ose humbje të tjera në periudhën në të cilën ato lindin. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë jo-monetare të klasifikuara si aktive financiare të disponueshme për shitje njihen në kapital.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të Pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar nëse ka evidence objektive që një aktiv financiar apo grup aktivesh financiare është zhvlerësuar. Në rastin e instrumenteve të kapitalit të disponueshme për shitje që kanë një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë të letrës me vlerë nën kostun e saj konsiderohet si tregues që kjo letër me vlerë është zhvlerësuar.

AYEN AS ENERGJI Sha
Shenime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2011

g. Vleresimin e kerkesave per arketim

Kerkesat per arketim jane njohur fillimisht me vleren e drejte dhe me pas jane matur me kosto te amortizuar duke perdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionin për zhvlerësim. Një provizion për zhvlerësim të llogarive të arketueshme do të bëhet kur ka prova objektive që Shoqëria nuk do të jete në gjendje të mbledhë të gjithë shumat sipas vlerave origjinale të të arketueshmeve.

Vështirësi të mëdha financiare të klientit, mundësia që klienti do të falimentoje ose do të kryejë riorganizim financiar, dhe mospagimi i detyrimeve do të konsiderohen si prova që llogarive të arketueshme duhet të zhvlerësohen.

h. Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to

Paraja dhe ekuivalentet e parasë (mjetet monetare) përfshijnë orkën, depozitat në para me bankat, investime të tjera afatshkurtra tejet liku dhe me maturim fillstar prej tre ose më pak muajsh.

i. Huate

Huate e marra me interes regjistrohen fillimisht me vlerën e drejte. Pas njohjes fillestare jane te vleresuara me koston e amortizuar. Interesat e perlllogaritur jane njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe detyrim ne llogarive e interesave te perlllogaritura.

j. Llogarite e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke aplikuar metodën e interesit efektiv.

k. Provizionet

Një provizion njihet kur ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për vlerën e detyrimit. Provizionet rishikohen çdo datë të pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin me të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material, vlera e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhshme operative.

l. Te Ardhurat

Te ardhurat regjistrohen sipas mases se realizimit te tyre dhe lidhjes qe ato kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pavaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes. Te ardhurat nga interesat regjistrohen ne momentin e maturimit te tyre.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të vota.

m. Qirate

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rrëziveve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiramarrësi klasifikohen si të qiro operative. Pagesat e qirave të zakonshme (duke përjashtuar stimuluesit e vendosur nga qiramarrësi) njihen me metodën lineare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së qirasë.

n. Tatimi mbi fitimin

Tatimi aktual mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e ligjit "Për tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë" duke përfshirë gjithë detyrimet për tatimin mbi fitimin të pagueshme për vitin ushtrimor. Tatimet aktuale janë tatime për të paguar që rezultojnë nga të ardhurat e tatueshme, duke përdorur shkallën tatimore që është në fuqi në datën e bilancit, dhe çdo rregullim në tatimet për të paguar që rrjedh nga vitet e kaluara.

Shkalla tatimore për tatimin mbi fitimin për vitin ushtrimor është 10%.

AYEN AS ENERGJI Sha
Shtenime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2011

o. Fondi i pensioneve

Shoqeria paguan kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurime shendetesore per punonjesit e saj sic eshte parashikuar ne legjislacionin social ne Shqiperi. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjes per pagesen e pensioneve dhe shpenzimeve shendetesore. Nuk ka asnje detyrim tjetur ne lidhje me fondin per pensione dhe shpenzimeve shendetesore.

p. Zerat jashte bilancit

Mareveshjet e regjistruara jashte bilancit pasqyrojne kontratat (pa transferim parash) midis Shoqerise dhe Institucioneve Financiare. Keto kontrata, ne pergjithesi, jane per detyrime financiare ose garanci. Ato paraqesin detyrimin e Shoqerise ndaj Bankes per te kryer dicka gjate ose deri ne nje periudhe te caktuar kohore. Keto marreveshje regjistrohen kur detyrimi ka lindur. Vlera qe regjistrohet ne zerat jashte bilancit korespondon me shumen e garantuar ose me vleren e kontraktuar sipas marreveshjes. Ne daten e maturimit behet anulimi i veprimit.

q. Ngjarje pas bilancit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e Shoqerise në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

3. Menaxhimi i Riskut Financiar

Aktivitetet e grupit e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie të rrezqeve financiare, që përfshijnë riskun e kreditit dhe riskun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave. Menaxhimi i riskut të Shoqerise fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit.

Menaxhimi i riskut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut, si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit dhe investimi i liru ditot të tepërt.

a. Rreziqet e tregut

Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit vjen nga fakti se shoqeria ka detyrime në monedha të huaja, respektivisht në Euro dhe USD ndërkohë që shumica e aktiveve të saj paraqiten në Lekë. Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqerise e shprehur në monedha të huaja paraqitet si më poshtë:

	<i>Ne leke</i> <u>2011</u>
Aktivitet	
Mjetet monetare	
-EUR	2,647
-USD	0
	<u>2,647</u>
Detyrimet	
Huata	
-EUR	0
-USD	89,795,901
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	0
-EUR	39,364,148
-USD	0
	<u>129,160,049</u>

Tabela vijuese paraqet ndjeshmërinë e shoqërisë nga rritjet dhe uljet e LEK-ut Shqiptar kundrejt monedhave të huaja. Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehur në monedhe të huaja në fund të vitit dhe një korigjim në vlerën e drejte është llogaritur për një ndryshim prej 10% në normat e këmbimit valutor. Vlera pozitive apo negative tregon për një rritje/ rënie të fitimit ose të kapitalit, që ndodh kur Leku dobësohet/ forcohet në vlerë ndaj monedhave të tjera me + / - 10%.

Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhave të huaja

	Shuma neto	10%	-10%
Fitimi ose humbja	(129,157,398)	(12,915,738)	12,915,738

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e drejte e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhet si pasojë e ndryshimeve të normave të interesit në treg. Shoqëria nuk ka detyrime që mbartin interesa fikse apo variable. Shoqëria ka përfiton të ardhura nga interesat nga llogaritë e saj bankare.

b. Rreziqe të tjera të cmimeve

Çmimet e instrumenteve të kapitalit

Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të çmimit të instrumenteve të kapitalit pasi nuk mban aktive financiare që të përfshijnë instrumente të kapitalit në detyrime të bilancit. Nuk është politike e Grupit të blejë instrumente të tillë dhe të ekspozohet ndaj rrezikut të çmimit lidhur me lëvizjet në indokset e tregut të kapitalit.

Çmimet e shitjes

Shoqëria është në vitin e parë të akt vitit të saj dhe parashikon një fazë afatmesme investimi, gjatë së cilës nuk parashikohet aktivitet sh. tje.

c. Risku i Kredise

Shoqëria nuk ka një ekspozim të lartë ndaj riskut të kredise pasi ajo nuk ka filluar aktivitetin e sh. tje dhe si rrjedhim nuk ka llogari të arketueshme nga klientët.

Klasa e aktiveve financiare në fund të vitit pasqyrohet si më poshtë:

	Ne leke 2011
<i>Klasat e aktiveve financiare – Vlera kontabel</i>	
Kapitali aksionar i papaguar	12,600,000
Llogari të arketueshme dhe të tjera	2,755,465
Mjetet monetare në arke dhe në banke	82,729,380
	98,084,845

Risku i kredisë për mjete monetare në arke dhe në banke konsiderohet i papërfillshëm pasi palët e treta janë banka me reputacion të cilat kanë vlerësime të cilësisë së lartë të kredisë nga vlerësuesit e jashtëm.

d. Risku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i likuiditetit nënkupton mbajtjen e shumave të mjaftueshme të parave dhe letrave të tregtueshme si edhe mbajtjen e të arketueshmeve të përshtatshme që mund të arkëtohen në kohë brenda afateve të paracaktuara.

AYEN AS ENERGJI Sha
Shenime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2011

Tabela e mëposhtme paraqet maturitetin e mbetur kontraktual te detyrimeve financiare te Shocerise. Tabela eshte pergatitur ne bazën e flukseve te paskontuara te parasë për këto detyrime financiare.

Me 31 Dhjetor 2011	Afatshkurtra	Nga 1 deri	Afatgjata	Total
	Deri ne 12 muaj Leke	ne 5 vjet Leke	Me vone se 5 vjet Leke	
Huamarrje te tjera afatgjata	-	-	106,519,266	106,519,266
Llogari te pagueshme dhe te tjera	40,309,022	-	-	40,309,022
	40,309,022	0	106,519,266	146,828,288

4. Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM)

Lovizjet e Aktiveve e Afatgjata Materiale (AAM) gjate vitit ushtrimor jane pasqyruar ne tabelen e mëposhtme:

Pershkrimi		Automjete	Pajise Informatike	Mobilje dhe Urendi	Ne proces	TOTAL
Bilanci i Celjes	01.01.2011 AQT Vlera Bruto	-	-	-	-	-
Bilanci i Celjes	01.01.2011 Amortiz Akumul	-	-	-	-	-
Bilanci i Celjes	01.01.2011 VLERA NETO	-	-	-	-	-
Hyrjet 2011	Vlera Bruto	4,504,525	253,583	3,127,623	141,167,187	149,142,918
Daljet 2011	Vlera Bruto	-	-	-	-	-
Riklasifikim i Aktiveve		+/-				
Amortizimi i Vitit Ushtrimor		(459,452)	(23,904)	(272,797)	-	(756,153)
Provizionet		-	-	-	-	-
Bilanci i Mbylljes 31.12.2011	AQT Vlera Bruto	4,594,525	253,583	3,127,623	141,167,187	149,142,918
Bilanci i Mbylljes 31.12.2011	Amortiz Akumul	(459,452)	(23,904)	(272,797)	-	(756,153)
Bilanci i Celjes	01.01.11 VLERA NETO	4,135,073	229,679	2,854,826	141,167,187	148,386,764

Gjate vitit 2011 Shoceria ka blere 149,143 mije leke Aktivte Afatgjata Materiale, pjesa me e madhe e te cilave lidhen me investimin ne proces. Gjate ketij viti nuk ka patur asnje nxjerrje jashte perdorimit te Aktiveve Afatgjata Materiale. Me 31 Dhjetor 2011 asnje nga Aktivet Afatgjata Materiale nuk ka qene e vendosur si kolateral.

5. Parapagime per shpenzimet e shtyra

	2011 All '000
Shpenzime te periudhave te ardhshme	7,760
Parapagime te dhena	14,850
TOTALI	22,610

AYEN AS ENERGJI Sh.a
Shenime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2011

6. Kapitali Aksionar i Papaguar

Shuma prej 12,600 mije ALL paraqet kapitalin e papaguar te ortakut AS Energy, e cila pritet te arketohet brenda vitit 2012.

7. Te tjera Kerkesat per Arketim

	2011 ALL '000
TVSH	2,701
Tatim Fitimi	40
Te tjera	14
TOTALI	2,755

8. Likuiditete dhe Vlera te tjera Arke

	2011 ALL '000
Deposita ne banke e llogari te tjera	82,447
Para ne dore	282
TOTALI	82,729

9. Kapitali

Gjate vitit ushtrimor struktura e kapitalit te shoqerise paraqitet si vijon:

	2011 ALL '000
Kapitali i shoqerise	140,000
Fitimi i periudhes	17,747
TOTALI	122,253

Numri total i aksioneve te autorizuar te cilat janë regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit është 1,400 me vlerë nominale 100,000 Lekë për aksion. Struktura e kapitalit aksionar paraqitet si ne shenimin 1 te pasqyrave financiare.

10. Huamarrje te tjera Afatgjata

Huamarrjet perbshen si vijon:

	2011 ALL '000
Detyrime ndaj ortakëve	106,519
TOTALI	106,519

Pagesa e huamarrjeve pritet qe te ndodhe pas 5 viteve. Huaja nuk mbart interes dhe eshte e shprehur ne USD. Ajo eshte rindaluesuar ne fund te vitit me kursin e kembimit sipas Bankes se Shqiperise ne daten 31.12.2011.

AYEN AS ENERGJI Sha
Shënime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2011

11. Furnitoret

Detyrimet e kerkueshme deri ne nje vit perbehen nga:

	2011 ALL '000
Furnitore per fatura te pranuar	140
Furnitore per fatura te pamberitura	39,364
Debitore dhe kreditor te tjere	355
TOTALI	39,859

12. Shteti

	2011 ALL '000
Detyrime per Sigurimet Shoqerore	450
TOTALI	450

13. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Struktura e shpenzimeve te tjera te kryera deri me 31 Dhjetor 2011 paraqitet si me poshte :

	2011 ALL '000
Shpenzime materiale	1,004
Transport	505
Post e telekomunikacion	413
Konsulence kontabel	342
Mirembajtje e Riparime	139
Siguracione	165
Te tjera	2,585
TOTALI	5,153

14. Shpenzimet e Personelit

Struktura e shpenzimeve te personelit paraqitet si me poshte:

	2011 ALL '000
Shpenzime page	16,500
Shpenzime per kontribute	492
Kapitalizimi i shpenzimeve	-12,608
TOTALI	4,384

Numri i punonjese ne muajin Dhjetor 2011 eshte 8.

Nje pjese e shpenzimeve per punonjesis, qe lidhet ne menyre direkte me procesin e ndertimit te aktiveve atafajata material, eshte kapitalizuar ne zerin Aktive ne Procces ne seksionin e Aktiveve Afatgjata Materiale.

AYEN AS ENERGJI Sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare
Per ushtrimin e mbylur me 31.12.2011

15. Struktura e Rezultatit Financiar

Struktura e rezultatit financiar deri me 31 Dhjetor 2011 paraqitet si me poshte:

	2011 ALL '000
Te Ardhura Financiare	
Interesa Positive	1,973
Diferenca pozitive kembimi	303
Shpenzime Financiare	
Interesa te llogaritura	
Diferenca negative kembimit	(9,730)
	7,454

16. Llogaritja e Tatimit mbi Fitimin

Ne percaktimin e rezultatit tatimor shoqeria ka marre ne konsiderate shpenzime e panjohura per efekte fiskale. Ato lidhen me:

	2011 ALL '000
Rezultati para Tatimit	-17,747
<i>Korrigjuar per:</i>	0
Te tjera shpenzime me dokumentacion jo te plote	427
Shpenzime te tjera te pazbritshme	235
FITIMI TATIMOR	-17,085
Tatimi Mbi Fitimin 10%	0

17. Palet e lidhura

Shoqeria ka transaksione me pale te lidhura si vijon:

	2011 ALL '000
<i>Kompensimet per Drejtimin</i>	
Administratori	9,571
	9,571
<i>Balanca e fundit te vitit qe lindin nga shitja/blerja</i>	
Furnitore per tatura te pambarritura AYEN Enerji	39,364
	39,364
<i>Te pagueshme ndaj paleve te lidhura</i>	
Hua Afatgjate nga AYEN Enerji	106,519
	106,519
<i>Te drejta ndaj paleve te lidhura</i>	
Kapitali i papaguar AS Energy	12,600
	12,600